



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e zhvillimit të arsimit
Ministry of Education and Science - Bureau for Development of Education

Udhëzues për mësimdhënësit për mënyrën e vlerësimit të nxënësve

**GJATË PERIUDHËS SË REALIZIMIT TË
MËSIMDHËNIES PËRMES MËSIMIT NË
DISTANCË**



Ky udhëzues është hartuar me qëllim që të tregojë mënyrat për vlerësimin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm formal në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në rrethana kur mësimdhënia realizohet me mësim në distancë. Zhvillimi i kompetencave të nevojshme për të jetuar dhe punuar me sukses në shekullin XXI, të tilla si të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja, zhvillimi i kreativitetit dhe inovacionit, përveç në programet mësimore dhe realizimit të mësimdhënies, duhet të jetë i dukshëm edhe në metodat për vlerësim që përdoren gjatë mësimit në distancë. Zhvillimi i teknologjisë ndikon në të gjithë komponentët e mësimit (të mësuarit, mësimdhënies dhe vlerësimit), duke siguruar modele të reja për realizimin e vlerësimit të nxënësve. Mësimi në distancë është një përvojë e re si për mësimdhënësit, ashtu edhe për nxënësit, prandaj është mirë të parashikohet prania fizike e herë pas hershme e nxënësve në klasë, në mënyrë që të sigurohet objektiviteti, transparenca, vlefshmëria dhe besueshmëria në vlerësimin e nxënësve.

Vlerësimi i arritjeve/përparimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë duhet të harmonizohet me qëllimet, përkatësisht rezultatet e të nxënit sipas programeve mësimore, në rastin konkret me programet mësimore të shkurtuara për 159 ditë që do të realizohen në vitin shkollor 2020/21. Gjithashtu, duhet të respektohen llojet e vlerësimit (formativ, sumativ), zgjedhja e metodave të mësimdhënies dhe teknikat e përshtatshme për vlerësim, instrumentet e vlerësimit që janë të përshtatshme për mësimin në distancë, respektivisht mjetet online të vlerësimit të nxënësve që i kemi në dispozicion.

1 Nevoja për të vlerësuar arritjet e përparimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë duke organizuar orë takimesh për vlerësimin e njohurive dhe aftësive me prani fizike në shkollë

Sjellja e nxënësve për të ndjekur mësimet në shtëpi është e ndryshme nga kur ata janë të pranishëm në shkollë. Nxënësit që mësojnë nga shtëpia, mund të jenë të hutuar për mënyrën më të mirë për të kryer detyrat dhe për të menaxhuar kohën e tyre, të cilën mësuesi mund ta interpretojë si dembelizëm ose mosinteresim i nxënësit.



Mënyra hibride (e kombinuar) e vlerësimit nënkupton mbështetjen dhe ndjekjen e arritjeve të nxënësve në realizimin e mësimin në distancë, si dhe takime të herpashershme konsultative/mentoruese me nxënësin në klasë. Organizimi i takimeve/orëve të herpashershme me prezencë fizike në klasë për të vlerësuar, inkurajuar nxënësit, kontrolluar atë që është arritur dhe vlerësuar njohuritë e tyre në shkollë, synon:

- ▶ *Plotësime të boshllëqeve në të nxënë:* Takim me nxënësit në grupe të vogla (qasje e diferencuar) sipas nevojës për të arritur njohuri dhe aftësi për mbështetje individuale për mënjanimin e boshllëqeve thelbësore në arritjen e rezultateve nga lëndët apo fushat/temat konkrete mësimore. Në klasë, mësimdhënësit shohin se si nxënësit përpiqen të gjejnë një zgjidhje. Mësimdhënësi në këto orë, përdor të dhëna nga ndjekja dhe vlerësimi i nxënësit gjatë mësimin në distancë dhe flet me nxënësit për të gjetur dhe ndihmuar tejkalimin e mangësive në njohuritë e marra (paqartësi, pamjaftueshëm të kuptuara etj.).
- ▶ *Inkurajim për mësim shtesë/të thelluar:* Kur disa nxënës tregojnë arritje më shpejtë se sa të tjerët, atyre duhet t'u ofrohen mundësi për zhvillim individual, për të mbështetur interesin e zmadhuar dhe veçantive. Përndryshe, këta nxënës mund të mërziten dhe të ndalojnë së kryeri detyrat. Në takimet/orët në kohët reale, duhet të mbështetet dhe të lehtësohet të menduarit e nxënësit për konceptet, të realizohen aktivitete interesante duke lidhur përvoja të botës reale (të menduarit kreativ).
- ▶ *Kujdes për zhvillimin shoqëror dhe emocional:* Kontrolli i zhvillimit të nxënësit është thelbësor, veçanërisht gjatë kësaj sfide (Kovid -19). E rëndësishme është që mësimdhënësi **të jetë në dispozicion të secilit nxënës në çdo kohë. Organizimi i takimeve/orëve me nxënësit në klasë**, si dhe zhvillimi akademik i tyre. Gjithmonë duhet pasur parasysh se puna nga shtëpia është një sfidë e madhe më shumë për nxënësit sesa për mësimdhënësin (për shembull: kur nxënësit kërkojnë më shumë kohë për të zgjedhur detyrat ose mundësinë për të rizgjedhur apo rishikuar një detyrë, mësimdhënësi këtë duhet ta mundësojë. Megjithatë mund të ketë nxënës që ekzagjerojnë kërkesa të tilla, mësimdhënësi duhet të supozojë se thirrja për ndihmë e shumicës së nxënësve është e vërtetë). Mësimdhënësi nuk di se cilat strese të mundshme kalon nxënësi në shtëpi. Prandaj, duhet të jetë një mbështetës, e jo një pengesë shtesë.
- ▶ Në këto takime/orë vlerësohen aftësitë praktike që vështirë se do të mund të demonstrohen në një klasë virtuale.



- ▶ Për realizimin e këtyre takimeve/orëve duhet të respektohen Protokollet për veprimin e shkollave fillore/të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut për realizimin e procesit edukativ – arsimor me prani fizike të nxënësve në vitin shkollor 2020/21 e botuar në „Gazeta zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 212/20”.

2 Organizimi i takimeve në klasë për të ndjekur përparimin e nxënësve

Takimet e mësimdhënësit me nxënësit për ndjekje, kontrollim dhe vlerësim të drejtpërdrejtë të përparimit të tyre në të mësuar, varet nga qëllimet/rezultatet e parashikuara dhe ato janë planifikuar dhe organizuar paraprakisht si më poshtë:

- ▶ Përgatitja e një orari mujor me nxënësit nga paralelja konkrete, varësisht nga numri i javor i orëve për lëndën konkrete (për lëndët në planin mësimor të përfaqësuar me 1-3 orë në javë – të paktën një takim në muaj, ndërsa për lëndët e përfaqësuar në planin mësimor me 4 apo më shumë orë në javë – së paku dy takime gjatë muajit). Takimet e mësimdhënësit me nxënësit për sa i përket kohëzgjatjes varen nga nevoja për konsultime dhe shkëmbim informacioni dhe duhet të zgjasin nga 20 deri 30 minuta.
- ▶ Në takime duhet të marrin pjesë më së paku 2 dhe më së shumti 10 nxënës. Kjo qasje mundëson që mësimdhënësi t'i kushtojë vëmendje të mjaftueshme secilit nxënës dhe të shohë vështirësitë/sfidat me të cilat përballen në arritjen e rezultateve të parashikuara në programet mësimore.
- ▶ Mësimdhënësi përdor takimin për të shpjeguar më tej boshllëqet e caktuara në të mësuarit e nxënësve, për të identifikuar dhe tejkaluar boshllëqet në mësimnxënie, për të inkurajuar të mësuarit shtesë, për të shkruar ushtrime me shkrim nga nxënësit, zgjedhja me shkrim e detyrave duke paraqitur të gjithë procedurën në matematikë, fizikë etj. Për kontrollim të njohurive me gojë (shpjegime të procedurave për zgjedhjen e detyrave, analiza të teksteve etj.) planifikohet numër më i vogël i nxënësve (nga 2 deri 5).
- ▶ Gjatë ditës, nxënësi mund të marrë pjesë në më së shumti 3 takime të organizuara për lëndë të ndryshme.
- ▶ Mësimdhënësi organizon takimet pas përfundimit të mësimit online të realizuar në turnin e parë (mëngjes), ose para mësimit online që realizohet në turnin e dytë (pasdite).



- ▶ Takimet/orët e planifikuara vendosen në faqen e internetit të shkollës dhe gjithashtu u dërgohen nxënësve dhe prindërve/tutorëve të tyre.
- ▶ Mësimdhënësi duhet të informojë nxënësit për qëllimin e takimit së paku 3 ditë para realizimit, që nxënësit të mund të vijnë të përgatitur sipas qëllimeve dhe kërkesave të mësimdhënësit.
- ▶ Takimet fizike me nxënësit, nuk janë të organizuara për lëndën e arsimit fizik dhe shëndetësor.
- ▶ Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, inkluzive/përfshirë në klasa të rregullta, në këto takime vijnë me prani të asistentit personal, ndërsa qëllimet e takimeve harmonizohen me PAI (planin arsimor individual). Takimi me këto nxënës është individual apo me numër të vogël nxënësish në grup, si dhe sipas nevojës mund të organizohet 3 apo më shumë herë gjatë muajit me nxënësin/ nxënësit e njëjtë.

3 Vlerësimi formativ dhe sumativ i nxënësve gjatë mëimit në distancë

Mësimdhënësi realizon vlerësimin formativ dhe sumativ të nxënësve gjatë realizimit të mëimit në distancë, njëjtë si gjatë realizimit të mëimit me prani fizike të nxënësve në shkollë.

3.1. Vlerësimi formativ gjatë mëimit në distancë

Në mësimin në distancë, zvogëlohen mundësitë për kontakt të drejt-përdrejtë dhe verbal si dhe ndjekje të përparimit të nxënësve. Prandaj, është e nevojshme të përshtasim vlerësimin formativ dhe sumativ sipas situatës së re. Mësimdhënësit duhet t'iu japin udhëzime të qarta nxënësve lidhur me rezultatet e pritura nga të mësuarit dhe mënyrën e ndjekjes, kontrollimin dhe vlerësimin e arritjeve të tyre (si të kontrollojnë sa kanë mësuar, çfarë provash të mbledhin, si të mësojnë në mënyrë të pavarur, si të kontrollojnë atë që është mësuar, si do të formohet nota).

Mësimdhënia në një klasë virtuale është një sfidë dhe mundësi për të bërë një hap përpara për vlerësim në mënyrë që të vlersohen proceset kognitive komplekse (analiza, sinteza, vlerësimi), në vend që të përvetësohen njohuritë faktike që, në fakt, janë qëllimi i edukimit. Kjo do të thotë që, në mësimdhënie dhe në vlerësimin në distancë, theksi duhet të jetë në atë që është e rëndësishme, përmbajtja që mësimdhënësit ligjërojnë dhe vlerësojnë duhet të përqëndrohet në atë që është e rëndësishme dhe jo në detaje apo fakte dytësore.



Hapat më të rëndësishëm të vlerësimit formal, mund lehtësisht t'i përshtaten situatës së klasës virtuale, dhe atë:

- ▶ Njohja me qëllimet e mësimin dhe rezultatet e pritura nga të nxënit. Nxënësit informohen gojarisht për atë që do të mësojnë dhe për atë që do të mund të bëjnë në fund të një ose më shumë aktiviteteve. Mirë është që ky informacion të ndahet edhe me prindërit/tutorët me të cilën do të sigurohet që ata të kyçen më shumë në ndjekjen e të mësuarit të fëmijës së tyre si dhe do të tejkalohen keqkuptimet eventuale në vlerësim për shkak të dallimeve të pritshmërive lidhur me atë që duhet të mësohet.
- ▶ Parashtrimi i pyetjeve dhe detyrave përmes së cilave mund të shihet të kuptuarit e asaj që mësohet. Nxënësve konkretisht u parashatrohen pyetje të shkurta, por edhe tërë grupit (për shembull: përgjigjet e pyetjeve të shkurta me shenja e saktë/jo e saktë, përmbledhja e përmbajtjeve të mësuarat më parë në një fjali). Mund të përdoret edhe komunikim i drejtpërdrejtë, përgjigja me gojë përmes video konferencës ose përmes telefonit, apo me shkrim (chat) për të kontrolluar çfarë din nxënësi, e çfarë jo, dhe në të njëjtën kohë t'i jepen udhëzime për mësim, materiale plotësuese, ta lidhë me nxënësit tjerë etj.
- ▶ Përveç pyetjeve për kontrollim sa dhe si nxënësit kanë mësuar, mund të ketë edhe pyetje shtesë të llojit: Çfarë është më e rëndësishme nga ajo që mësove?; Çfarë nuk është mjaft e qartë?
- ▶ Përdorimi i një larmie metodash dhe teknikash për kontrollim. Zbatohen të gjitha metodat e bazuara në vlerësimin e punimeve me shkrim (pyetje ese, disa lloje të projekteve, detyra hulumtuese, prezantime, teste, ushtrime kontrolli), dhe veçanërisht ditarët refleksiv dhe protofoliet elektronike janë të zbatueshme. Por, ka kufizime në përdorimin e disa metodave të ndjekjes, për shembull: vëzhgimi i performancave praktike (kryerja e ushtrimeve motorike, ndjekja e procesit të hulumtimit etj.). Mirë do të jetë të mos përdoren shumë teknika vlerësimi, që të vendoset një rutinë në përdorimin e teknikave të zgjedhura.
- ▶ Përfshirja e nxënësve në vlerësim (vetëvlerësim dhe vlerësim i ndërsjellë) me qëllim të mësimin nga njëri-tjetri. Vetëvlerësimi është më i përshatshëm tek detyrat me shkrim duke iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me vetë-reflektimin si: *Unë jam më i kënaqur me... Mendoj se mund të bëj më mirë...Gjëja tjetër që do të bëj është...*



3.2 Informata kthyese

Infotmata kthyese gjatë mësimit në distancë është veçanërisht e rëndësishme për të ruajtur motivimin dhe kontinuitetin në mësim. Në fillim, mësimdhënësi, bazuar në mundësitë teknike të disponueshme nga nxënësi, si dhe në mundësitë dhe kompetencat e veta, duhet të përcaktojë mënyrat më të përshtatshme për të komunikuar me nxënësit, e rrjedhimisht – për të dhënë informatë kthyese.

Informata kthyese mund të jepet në forma të ndryshme, por gjithmonë duhet të jetë i detajuar dhe konkret, me udhëzime për përmirësimin e të mësuarit. Çdo informatë kthyese duhet të përmbajë elementet në vijim: (1) çfarë është bërë mirë, (2) çfarë duhet të përmirësohet dhe (3) çfarë duhet të bëjë nxënësi për ta përmirësuar atë.

Kur jepni informatë kthyese asinkrone, mund të jetë në:

- ▶ **Formë të shkruar** – Përmes opsioneve të ndryshme për të komentuar në dokumentin që nxënësi dërgon, ose veçmas në një dokument të veçantë që nxënësi e merr përsëri përmes mekanizmit të vendosur të komunikimit (forma online e mësimit, rrjetit social, postës elektronike etj.). Informatat kthyese me shkrim janë një metodë e përshtatshme për lëndë të caktuar (për shembull: matematika, lëndë nga shkencat natyrore, apo shkencat teknike) si dhe lloje të caktuara të detyrave (për shembull: detyrat matematikore, pyetjet për test), por gjithashtu, me sukses mund të përdoret edhe në lëndë të tjera (për shembull: gjuha amtare/e huaj, lëndë nga shkencat shoqërore) gjatë vlerësimit të pyetjeve ese.
- ▶ **Formë audio dhe video** - Mësimdhënësi mund të regjistrojë informatën kthyese dhe t'ia dërgojë nxënësit në formën e një video ose audio inçizimi. Kjo qasje është e përshtatshme nëse informacioni është i detajuar dhe mjaft specifik dhe synon të ndikojë veçanërisht në aspektet socio – emocionale të motivimit. Në të njëjtën kohë, ka më shumë të ngjarë që mësimdhënësi të kuptohet si duhet, pasi përfshin informacione joverbale (toni i zërit).

Mësimdhënësi lehtësisht mund të përfshijë në portofolin elektronik të nxënësve dokumentet/regjistrimet që përmbajnë informatë kthyese dhe t'i përdorë ato për të ndjekur përparimin e nxënësit, si dhe për vlerësimin sumativ.

Kur jepet informatë kthyese e sinkronizuar, më e përshtatshme është një **bisedë e drejtëpërdrejtë me nxënësin** me telefon apo aplikacioneve online për komunikim (që i mundëson platforma ose aplikacionet tjera që do t'i përdorin shkollat etj.). Meqenëse kjo mënyrë e dhënies së informatës kthyese



kërkon më shumë kohë nga mësuesi, është mirë që ai/ajo të përfshijë seanca individuale për të dhënë komente në një pjesë të caktuar të ditës ose javës. Seanca të tilla u mundësojnë nxënësve të mbajnë kontakte dhe lidhje me shkollën si dhe ndjenjën se mësimdhënësit janë në dispozicion për tu dhënë atyre udhëzime dhe mbështetje.

Pavarësisht kontakteve dhe lidhjeve të rregullta përmes aplikacioneve online, është e nevojshme të organizohen takime fizike të mësuesve me nxënësit në klasë, në mënyrë që të ofrohen shpjegime shtesë për atë që nxënësi nuk e ka kuptuar gjatë mësimin në distancë, për të identifikuar nevojën për përmbajtje dhe materiale shtesë, derisa nxënësi ka interes të shtuar për lëndë të caktuara, për të mbështetur vetëvlerësimin etj. (Kapitulli 1)

3.3. Vlerësimi sumativ

Vlerësimi sumativ është pjesë e çdo lloj arsimit formal, pavarësisht se si zhvillohet. Një sfidë e veçantë në vlerësimin sumativ në arsimin në distancë është të sigurohet se ai është i vlefshëm dhe objektiv. Ekzistojnë mënyra dhe përvoja për të siguruar vlerësim cilësor sumativ të mësimin në distancë, që duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- ▶ **Vlefshmëria** (kontrollimi i rezultateve të pritura nga të mësuarit). Kjo sigurohet duke kontrolluar vetëm ato rezultate të pritshme që nxënësve u janë mësuar përmes mësimin në distancë.
- ▶ **Besueshmëria** (sa reflekton nota arritjet e nxënësit). Një shkallë e kënaqshme e besueshmërisë së notës në vlerësimin në distancë mund të sigurohet nëse jepen detyra autentike që e bëjnë të vështirë gjetjen e përgjigjeve të gatshme në materialet mësimore apo burime të tjera të informacionit, ndërsa në detyrat me të cilët kontrollohen të njohurit dhe të kuptuarit e fakteve, duhet të sigurohet kontrollimi i kohës për zgjedhjen e detyrave. Gjithashtu, në kontakt të drejtëpërdrejtë me nxënësin (online apo prani fizike) mësimdhënësi mund të kërkojë shpjegime plotësuese për të siguruar besueshmërinë e përgjigjeve. Për të siguruar besueshmëri më të madhe të notave sumative, në formimin e tyre është e rëndësishme që të përdoren njohuritë nga vlerësimi formativ (vlerësimi i punimeve më të mira/portofolio reprezentative) si dhe njohuritë e marra nga takimet fizike me nxënësit në shkollë.
- ▶ **Objektiviteti** (nëse do të vlerësonim përgjigjet e nxënësit nga një vlerësues tjetër, nxënësi do të merrte të njejtën notë). Objektiviteti i notave sigurohet nëse kriteret konkrete të vlerësimit të parapërgatitura respektohen vazhdimisht (kriteret e përcaktuara për pyetjet ese, përgjigjet me një kuptim tek test – detyrat) dhe zbatimi i qëndrueshëm i tyre nga mësimdhënësi. Nëse pjesët e vlerësimit të projektit ose esesë apo lista e shkurtër e pikave të përgjigjeve



të esesë ndahen, paraprakisht me nxënësit dhe prindërit, besimi i nxënësve dhe prindërve se vlerësimi është objektiv do të rritet.

- ▶ **Drejtësia / paanësia.** Vlerësimi objektiv në të njëjtën kohë është i paanshëm/i drejtë (vlerësimi nuk ndikohet nga faktorë të tjerë që nuk kanë të bëjnë me atë që vlerësohet, për shembull: gjinia, prejardhja sociale). Megjithatë, në vlerësimin në distancë nëse të gjithë nxënësit nuk kanë pajisje elektronike po aq të mira, kjo mund të ndikojë në cilësinë e detyrës (për shembull: disa kanë kompjuter, ndërsa disa vetëm celular), kështu që detyrat e vlerësimit sumativ duhet të jenë të tilla që të mos u japin përparësi atyre që kanë pajisje më të mira (për shembull: prezantimi teknik nuk duhet të jetë kriter, ose të gjithë të zgjedhin testin në mënyrë të njëjtë – qoftë në letër apo në kompjuter). Nota nuk duhet të ndikohet nga përshtypjet e para të mësimdhënësit për nxënësin. Ndodh që mësimi në distancë i përshtatet disa nxënësve që më parë kanë arritur rezultate më të dobëta të cilët mund të befasojnë me cilësinë e punës së tyre.
- ▶ Nëse nuk ofrohen kushte teknike për realizimin e vlerësimit sumativ duke përdorur metodën e testit, ajo realizohet në klasë për të cilën nxënësi do të jetë i njoftuar më parë.
- ▶ **Transparenca dhe qartësia** (nxënësit janë të njohur me metodën e vlerësimit). Nxënësit dhe prindërit duhet të njihen me atë që nxënësit duhet të arrijnë dhe si to të vlerësohet ajo: me cilat detyra, cilat do të jenë kriteret, si do të vlerësohen. Mësimdhënësi mund të bëjë një tabelë të provave, dëshmimeve/produkteve që nxënësi do të paraqesë si pjesë e portfolios elektronike që do të duhet të vlerësohet – çfarë duhet të paraqesin, deri kur dhe si të paraqesin dhe për këtë t'i informojnë në mënyrë të përshtatshme nxënësit dhe prindërit (duke vendosur platformën e specifikuar, dërgimi përmes postës elektronike ose përmes një grupi të caktuar aplikacionesh, ose dorëzimi i tyre në një takim fizik të organizuar në shkollë). Nxënësit duhet të kenë qasje në rubrikat dhe kriteret për vlerësimin e esëve, tu sigurohen teste praktike me pyetje ese të ngjashme me ato që do të përdoren. Ata, gjithashtu, duhet të informohen për ndikimin e arritjeve nga detyrat ese dhe/ose projektuese në notimin sumativ, njohurit për punimet më të mira në portofolin elektronik ose testin e mundshëm vjetor. Është mirë që t'i jepni një peshë të caktuar edhe rregullshmërisë dhe përmbushjes së detyrave.

Mësimdhënësi mund të organizojë takime fizike në shkollë/orë për vlerësimin e njohurive dhe aftësive edhe në vlerësimin sumativ nëse ekziston dilemë, përkatësisht nëse nuk ka elemente të mjaftueshme për vlerësimin sumativ të nxënësit/nxënësve. Kontrollimi me gojë në shkollë rekomandohet nëse nxënësi gjatë mësimin në distancë vlerësohet me një notë përfundimtare



sumative të shkëlqyeshme, dhe nuk ka elemente të mjaftueshme për të përfunduar një notë pozitive.

Kur formon notën sumative, mësuesi ka parasysh se sa aktiv ishte nxënësi në procesin e të mësuarit. Aktiv është nxënësi që merr iniciativën, përpiqet për pavarësi dhe inkurajon të tjerit të mësojnë. Në mësimin në distancë, mund të ndodhë që disa nxënës, për dallim nga vitet e mëparshme, për shkak të aftësive dhe njohurive të tyre dixhitale bëhen shumë aktiv dhe të pavarur, dhe kështu të bëhen shembuj pozitiv dhe t'i motivojnë edhe nxënësit e tjerë, dhe kjo duhet të vlerësohet.

Gjithashtu, vlerësohet edhe cilësia dhe rregullshmëria e detyrave të shtëpisë të nxënësit. Pastaj, shumë e rëndësishme është që mësuesi të japë informata të përshtatshme kthyesë për detyrat e shtëpisë në të cilën do të shpjegojë se çfarë është e mirë dhe ku ka mundësi për përmirësim.

4 Metodat dhe teknikat e vlerësimit gjatë mësimit në distancë

Teknikat më të zakonshme dixhitale që mësimdhënësit mund të përdorin për të vlerësuar arritjet e nxënësit, respektivisht teknikat më të zakonshme dixhitale për vlerësimin formativ dhe sumativ, në varësi të performancave të platformës përkatëse, janë:

- teste objektive me zgjedhjen e përgjigjeve të ofruara;
- teste me përgjigje të shkurtër;
- pyetje ese;
- diskutime;
- studimi i rastit;
- aktivitete të realizuara;
- lojra online;
- revistat e nxënësve, blog dhe ndërtimi i (wiki),
- portofolio elektronike (koleksion i punimeve të nxënësve që tregojnë rezultatet e arritura nga nxënësi përmes aktiviteteve të ndryshme në procesin e mësimit, për shembull: ese, postera, fotografi, video dhe audio inçizime, vepra arti etj.).

5 Vetëreflektimi i mësimdhënësit

Vetëreflektimi është thelbësore për të përmirësuar arsimin në distancë sepse lejon mësimdhënësit të vlerësojnë dhe përmirësojnë qasjet e mësimdhënies që ata kanë përdorur. Të dhënat e mbledhura për mësimin e nxënësve duhet të përdoren për të përmirësuar të mësuarit (mësimnxënien) e tyre dhe/ose për të përmirësuar mësimdhënien.



Bashkëpunimi me prindërit/tutorët

Prindërit duhet të përfshihen në mësimin në distancë dhe në ndjekjen e përparimit të fëmijëve të tyre. Mësimdhënësi duhet t'i informojë prindërit për pritjet nga nxënësit, detyrat që ata (do t'i) marrin, suksesin në përgatitjen e tyre, udhëzimet për punën e mëtejshme. Mësimdhënësi duhet të përpiqet të kontaktojë sidomos me prindërit, **të cilët në kushte normale nuk tregojnë interes për mësimnxënien e fëmijës.**

Prindërit mund t'i dërgojnë komente mësimdhënësit **nëse nxënësi ka punuar në mënyrë të pavarur, si ishte interesi për detyrat e kryera, nëse diçka nuk ishte e qartë për të, nëse ai është i interesuar në një fushë/lëmi etj.**

